

Republika e Kosovës / Republika Kosovo / Republic of Kosovo		
Autoriteti i Aviacionit Civil i Kosovës / Autoritet Civilnog Vazduhoplovstva Kosova / Civil Aviation Authority of Kosovo		
CAA		
Nr. i prot.	2025/20P/508	
Reprot./Vot. Nr.		
Faqet: 10	Kopje: 1	Data: 30.12/2025
Stranica/Pages	Kopija/Copy	Datum/Date
Hyrës/Introduct.	☐	
Dalës/Export	☒	
Brondshëm/Internat. Travel	☐	
Pristina/Prishtina/Pristina		

Nr. 58/ZDP/VE/2025

Datë: 30 dhjetor 2025

Në mbështetje të nenit 14.1, 14.2, 15.1(f), 21.2 dhe 81 të Ligjit nr. 03/L-051 për Aviacionin Civil, nenit 41 të Ligjit nr. 06/L-113 për Organizimin dhe Funksionimin e Administratës Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura, nenit 13 dhe 15 të Rregullores së AAC-së nr. 3/2016 mbi përcaktimin e skemës së përbashkët të tarifave për shërbimet e navigacionit ajror, dt. 10 shkurt 2016 ("Rregullorja") dhe Nenit 23 i Ligjit nr. 08/L-305 për Ofruesin e Shërbimeve të Navigacionit Ajror – KANS,

Duke vendosur sipas propozimit final të Ofruesit të Shërbimeve të Navigacionit Ajror (KANS), dt. 25 nëntor 2025, për tarifën njësi terminale për vitin 2026,

Drejtori i përgjithshëm i Autoritetit të Aviacionit Civil të Republikës së Kosovës merr këtë:

VENDIM

1. Refuzohet miratimi i tarifës njësi terminale 2026 prej 334.29 EUR siç është propozuar nga KANS më dt. 25 nëntor 2025.
2. Përcaktohet tarifa njësi terminale 2026 në Republikën e Kosovës në vlerë prej 313.50 EUR.
3. Kjo tarifë u ngarkohet shfrytëzuesve të shërbimeve të navigacionit ajror nga KANS për shërbimet terminale të navigacionit ajror që ofron në hapësirën ajrore të Republikës së Kosovës duke filluar nga data 1 janar 2026.
4. Obligohet KANS që të kërkojë aprovim nga AAC për çdo ndryshim në projektet kapitale të aprovuara që të financohen me tarifën njësi terminale 2026.
5. Ky Vendim hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit të tij.

ARSYETIM

Me qëllim të vlerësimit të propozimit të KANS për përcaktimin e tarifës njësi terminale për vitin 2026, AAC-ja ka marrë parasysh dokumentacionin si në vijim:

- Raporti vjetor financiar për vitin 2024 i ASHNA, 27 shkurt 2025;

- Dokumentet e dorëzuara nga ASHNA gjatë raportimit të parë (kostoja bazë fillestare për të dhënë shërbimin në vitin 2026 përmes tabelave të raportimit nga shtojca II dhe VI e Rregullores 3/2016), dt. 28 mars 2025 me numër protokolli 2025/BNRREA/123;
- Raportin vjetor të punës të vitit 2024, dt. 28 mars 2025;
- Konkluzionet e AAC-së nga përmbyllja e shqyrtimit rregullator të raportimit të parë të ASHNA-së sa i përket tarifës njësi 2026 të cilat i janë komunikuar ASHNA-s më 12 qershor 2025;
- Raporti i BNRREA mbi pasqyrat financiare të ASHNA-s të dt. 13 qershor 2025 për vitin financiar të përfunduar më 31 dhjetor 2024 dhe Raportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit të publikuar në maj 2025 për pasqyrat financiare të ASHNA-s për vitin 2024;
- Njoftimet e KANS përmes emailit të dt. 30 shtator, 20 tetor dhe 6 nëntor se nuk kanë mundësi ta dorëzojnë propozimin final në AAC sipas afatit të përcaktuar (30 shtator 2025) pasi që Këshilli Mbikëqyrës nuk e ka miratuar buxhetin 2026;
- Dokumentet e dorëzuara nga KANS gjatë raportimit të dytë (kostoja bazë përfundimtare për të dhënë shërbim gjatë vitit 2026 përmes tabelave të Raportimit nga shtojca II dhe VI e Rregullores) si dhe përmes Formave të plotësuara me të dhëna plotësuese të tabelës 1 dhe 2, më dt. 25 nëntor 2025 me numër protokolli 2025/ZDP/469;
- Kërkesën për aprovim të buxhetit të KANS 2026/2028 dërguar nga Drejtori i përgjithshëm i KANS tek Këshilli Mbikëqyrës i KANS, 3 dhjetor 2025;
- Projektligjin mbi ndarjet buxhetore të buxhetit të Republikës së Kosovës për vitin 2026;
- Raportin e shpenzimit të buxhetit të ASHNA 1 janar- 15 dhjetor 2025 respektivisht 1 janar- 25 dhjetor 2025 të pranuar nga Departamenti i buxhetit të MFPT, 16 dhjetor/26 dhjetor 2025
- Raportin e trajnimeve të realizuara gjatë vitit 2025 të datës 19 dhjetor 2025;
- Planin e aprovuar të trajnimeve të KANS për vitin 2026, i dërguar në AAC më 22 tetor 2025;
- Dokumentet e përditësuara të dorëzuara nga KANS gjatë raportimit të dytë të plotësuar e ndryshuar (kostoja bazë përfundimtare për të dhënë shërbimin gjatë vitit 2025 përmes tabelave të Raportimit nga shtojca II dhe VI e Rregullores), dt. 11 dhjetor 2025;
- Rregullore për organizimin e brendshëm dhe funksionimin e KANS miratuar nga Këshilli Mbikëqyrës më 29 prill 2025;
- Rregullore për menaxhimin e financave të KANS miratuar nga Këshilli Mbikëqyrës më 29 prill 2025;
- Rregullore për marrëdhënien e punës së personelit të KANS miratuar nga Këshilli Mbikëqyrës më 29 prill 2025;

- Rregullore për pozitat e punës, përshkrimin e vendeve të punës dhe kompenzimin e personelit të KANS miratuar nga Drejtori i përgjithshëm i KANS më 8 korrik 2025;
- Raportin preliminar të njësive terminale të shërbimit (TSU) për muajin dhjetor 2025 të dorëzuar nga KANS më 15 dhjetor 2025;
- Parashikimin e numrit të udhëtarëve dhe të fluturimeve për muajt e fundit të vitit 2025 si dhe të vitit 2026 të dorëzuar nga LKIA të dt. 16 dhjetor 2025;
- Dëshmitë mbi realizimin e projekteve kapitale 2025 të aprovuara nga AAC-ja të dërguara nga KANS në periudhën 25 nëntor-22 dhjetor 2025;
- Planin vjetor të biznesit të KANS për vitin 2026, të datës 1 dhjetor 2025 të dërguar në AAC më 1 dhjetor 2025;
- Planin e biznesit për periudhën 2026-2030 të KANS të datës 1 dhjetor të dërguar në AAC më 1 dhjetor 2025;
- Raportin mbi propozimin e tarifës terminale njësi 2026 të hartuar nga KANS dhe të shpërndarë te kompanitë ajrore për konsultime në pajtim me nenin 15 të Rregullores nr. 3/2016 të AAC-së, dt. 26 nëntor 2025;
- Raportimin nga KANS të dt. 19 dhjetor 2025 se pas përmbylljes së afatit tre javor të konsultimit publik (26 nëntor - 16 dhjetor 2025) në lidhje me përcaktimin e tarifës terminale, nuk kanë pranuar komente nga kompanitë ajrore;
- Obligacionet qeveritare 10 vjeçare të Bankës Qendrore të Kosovës të publikuara më 28 gusht 2025 në ankandin për obligacione nga BQK;
- Informatat dhe dokumentacionin shtesë që është pranuar nga Zëvendës Drejtori për shërbime administrative dhe financiare i KANS përmes komunikimit elektronik në periudhën 25 nëntor- 22 dhjetor 2025 me qëllim të përcaktimit të tarifës njësi terminale për vitin 2026 gjatë periudhës së shqyrtimit;

Pas shqyrtimit rregullator të secilës prej kategorive të kostove të propozuara në përputhje me metodologjinë dhe parimet e përcaktuara në Rregullore si dhe parashikimit të njësive të shërbimit terminal që pritet të shërbehen gjatë vitit 2026, Departamenti për Bashkëpunim Ndërkombëtar dhe Rregullim Ekonomik të Aviacionit (BNRREA) në AAC ka konkluduar si në vijim:

Kostot për paga dhe pagesa shtesë:

Në bazë të Rregullores për pozitat e punës, përshkrimin e vendeve të punës dhe kompenzimin e personelit të KANS, prej 1 janar 2026 fillon zbatimi i një skeme të re kompenzimesh. Përpos pagës bazë ku përfshihet edhe kompenzimi për përvojën e punës dhe kompenzimi për përvojën e punës në KANS, personeli ka të drejtë në pagë shtesë për punën jashtë orarit, gjatë festave dhe natën, pagë për funksionet shtesë si dhe shtesat e gradimeve dhe kualifikimeve. Të gjitha pagesat përpos pagës bazë këtu e tutje do të quhen pagesa shtesë. Sidoqoftë, KANS ka dorëzuar tabelën e pagave

të papërshtatur me rregulloren e re duke përdor emërtime të shtesave në pagë që janë inekzistente në rregulloren e re.

Për vitin 2026, KANS ka propozuar një kosto prej 4,581,851.80 EUR për paga dhe pagesa shtesë të 187 punëtorëve. Kjo kosto përfaqëson një rritje prej 19% në krahasim me përcaktimin e AAC-së për këtë kategori për vitin 2025. Kostoja e propozuar është rritur, mes tjerash, për shkak të rritjes së pagave përmes Rregullores së referencuar më lartë në masën rreth 15% për personelin operativ dhe në masë më të vogël për personelin administrativ. Në vitin 2026 planifikohet të rekrutohen 18 pozita të reja (12 kontrollorë të trafikut ajror, 3 student ATSEP administratorë, 1 udhëheqës i divizionit të energjisë dhe klimatizimit, 1 menaxher i departamentit ligjor dhe një shtëpiak)

Faktor i theksuar kontribues në koston e pagave që është rritur në 4 vitet e fundit janë pagat shtesë (pagesa për punë jashtë orarit, festa e natën) që për vitin 2026 arrin vlerën 548,216.02 EUR megjithë rekrutimin e vazhdueshëm të personelit të ri. AAC përsërit kërkesën që KANS të rrisë disiplinën e shpenzimit në këtë aspekt, sidomos të adresoj orët shtesë të cilat ngritin kostot.

AAC-ja ka bërë analizën e këtyre kostove dhe përpos parashikimit të shtesave që nuk kanë bazë në rregullore ka vërejtur se në kosto nuk janë futur të gjitha pagat e departamentit të financave. Pas komunikimit me KANS janë ridorëzuar pagat në fjalë të përmirësuar përderisa nuk kemi pranuar përgjigje të pranueshme deri në afatin e përcaktuar në lidhje me koston për shtesat transitorë të cilat nuk kanë bazë ligjore, prandaj kostot e shtesave transitorë nuk do të përfshihen në koston e pagave për vitin 2026, ndërsa janë përfshirë të gjitha kompensimet e përmendura në Rregulloren e referencuar më lart.

Pas rikalkulimit, AAC ka përcaktuar si të arsyeshme dhe pranueshme koston e pagave prej 4,544,049 EUR për paga bazë dhe pagesa shtesë në përputhje me rregulloren. Numri i përcaktuar i personelit është 187 aq sa ka propozuar KANS.

Kostot tjera operative:

Në propozimin final të datës 24 nëntor 2025 KANS ka propozuar kostot operative në vlerë prej 2,865,240 EUR apo 17% më shumë se sa ka përcaktuar AAC-ja për vitin 2025.

AAC ka shqyrtuar listën e shpenzimeve operative për vitin 2026 që mban vlerën totale prej 2,865,240 EUR në të cilën ka vërejtur se si edhe vitet paraprake linjat me koston më të lartë janë Trajnimet (750,000 EUR) dhe Mirëmbajtja (431,000 EUR).

Gjatë shqyrtimit të realizimit të buxhetit për vitin 2025 është konstatuar që KANS deri më 19 dhjetor të vitit 2025 ka realizuar 691,214 EUR të linjës së trajnimeve nga 790,000 EUR sa ishin aprovuar nga AAC-ja kryesisht për shkak të rekrutimit/trajnitimit të 11 kontrollorëve të rinj që sipas KANS kjo vlerë është rreth 500,000 EUR. Sa i përket shpenzimeve operative në përgjithësi, vërehet që nga 2,443,658 EUR sa janë aprovuar nga AAC-ja për vitin 2025 deri më 26 dhjetor 2025 janë shpenzuar 2,154,023 EUR apo më shumë se 80% e buxhetit. Edhe pse në vitin 2025 përqindja e realizimit është më e madhja në vitet e fundit, theksojmë se mos realizimi i buxhetit të shpenzimeve operative vazhdon të jetë prezent në vitet e fundit. Kjo dukuri kërkon trajtim të

veçantë nga menaxhmenti i KANS në kuptim të planifikimit dhe menaxhimit më të duhur meqenëse vetëm sa e rrit borxhin ndaj kompanive ajrore.

AAC pasi ka shqyrtuar secilën linjë të kostove operative të parapara për vitin 2026 dhe raportin e realizimit të buxhetit gjatë vitit 2025, dhe duke pasur parasysh metodologjinë e rregullores sipas së cilës kompanitë ajrore nuk duhet të paguajnë më tepër sesa kostot e shkaktuara, AAC-ja ka përcaktuar si të arsyeshëm dhe pranueshëm një buxhet operativ prej 2,721,978 EUR për vitin 2026 që përfshin edhe shpenzimet komunale prej 124,700 EUR.

Kostoja e zhvlerësimit dhe kostoja e kapitalit:

KANS ka propozuar që kosto e kapitalit dhe zhvlerësimit për vitin 2026 të jetë 907,116.16 EUR prej të cilave kosto e zhvlerësimit në vlerë prej 761,531 EUR ndërsa kosto e kapitalit në vlerë prej 145,585 EUR. Siç është shpjeguar detajisht në vazhdim, pas finalizimit të listës së rregulluar të aseteve, kalkulimit të zhvlerësimit dhe koston së kapitalit si për asetet që janë në funksion më 2025 ashtu edhe për ato që planifikohen të futen në funksion gjatë 2026 dhe aplikimit të normës prej 4.20%, AAC-ja ka përcaktuar që kosto e zhvlerësimit dhe kosto e kapitalit për vitin 2026 të jetë 894,274 EUR.

a) Kostoja e zhvlerësimit të aseteve aktuale

AAC ka vërejtur se lista e aseteve të rregulluara 2026 është përditësuar për të përfshirë asetet që janë financuar nga tarifa terminale e navigacionit 2025 (1. Rregullimi dhe renovimi i hapësirave të punës 2. Furnizimi me UPS industrial 3. Blerja e mobiljeve dhe inventarit dhe 4. AHMS, ndërsa projekti 5. Pajisje per Linjat e dedikuara me shtetet fqinje Voice +Data është financuar nga granti qeveritar).

Mirëpo, në bazë të dëshmive të dorëzuara deri më 22 dhjetor 2025 prej këtyre projekteve kapitale të aprovuara nga AAC për vitin 2025 është realizuar pjesërisht gjatë vitit 2025 vetëm projekti 1. Rregullimi dhe renovimi i hapësirave të punës në vlerë prej 2,325.00 EUR nga 28,608.00 EUR sa kanë qenë të aprovuara nga AAC. Sa i përket projektit AHMS, KANS ka propozuar që vetëm një pjesë prej 30,000 EUR do të realizohet gjatë vitit 2025 ndërsa pjesa tjetër në vlerë prej 568,594 është vendosur si propozim për investim gjatë vitit 2026. Për projektet tjera, duke përfshi pjesën e projektit AHMS në vlerë prej 30.000 EUR, KANS nuk ka dorëzuar dëshmi të pagesës dhe nuk pritet të hyjnë në funksion gjatë vitit 2025 rrjedhimisht janë kosto të pa-pranueshme. AAC ka vërejtur se për projektin "Furnizim me UPS industrial", KANS ka parashikuar kosto të zhvlerësimit që nga viti 2018 edhe pse kjo pajisje ende nuk është liferuar as në fund të vitit 2025. Rrjedhimisht kjo kosto është fshirë nga lista e rregulluar e aseteve. Pas përmirësimit të të gjitha pasaktësive në listën e rregulluar të aseteve dhe duke qenë se në koston e ofrimit të shërbimit mund të futen vetëm ato aset të cilat janë në funksion gjatë vitit taritor AAC ka vendosur se kostoja e pranueshme e zhvlerësimit të aseteve aktuale është 681.600 EUR nga 702.906 EUR sa ka propozuar KANS.

Pra, si përfundim, KANS ka arritur që vetëm një projekt kapital ta realizojë pjesërisht gjatë vitit 2025 që tregon për nivel shumë të ulët realizimi projektsh kapitale. Shqyrtimi rregullator ka treguar se një pjesë e madhe e projekteve kapitale të aprovuara që të financohen nga tarifa është iniciuar në platformën publike të prokurimit në 4 mujorin e fundit të vitit 2025 dhe kjo ka sjellë tek situata që ato të mos hyjnë në shërbim të kompanive ajrore gjatë vitit 2025 siç ishte paraparë. Duke pasur parasysh metodologjinë specifike të njohjes së zhvlerësimit paraprak për asetet e reja AAC ripërsërit kërkesën që iniciimi i projekteve kapitale të financuara nga tarifa terminale e navigacionit të bëhet në fillim të vitit.

b) Kostoja e zhvlerësimit të aseteve të reja

Sa i përket kostonë së zhvlerësimit të aseteve të reja, KANS ka propozuar një kosto prej 58,625 EUR. AAC ka vërejtur që në bazën e rregulluar të aseteve KANS ka futur asetet e 11 projekteve të reja të planifikuara për vitin 2026 dhe për secilat ka parashikuar një periudhë kohore të arsyeshme se kur pritet të hyjnë në funksion si dhe zhvlerësimin përkatës. Gjithashtu ka vendosur edhe projektin AMHS në vlerë prej 568,594 EUR i cili është projekt i aprovuar për 2025 por pasi që nuk ka mundur të realizohet është bartur në vitin 2026. Edhe pse KANS nuk e ka deklaruar këtë kosto në tabela, AAC e ka njohur këtë si kosto duke e futur në kalkulim.

Pas shqyrtimit të Kërkesës për aprovim të buxhetit të KANS 2026/2028 dërguar nga Drejtori i përgjithshëm i KANS tek Këshilli Mbikëqyrës i KANS, 3 dhjetor 2025 dhe arsyeshmërisë për të gjitha projektet kapitale, AAC e aprovon këtë kosto të zhvlerësimit të aseteve të reja përpos kostonë së zhvlerësimit të katit të dytë të ndërtesës së KANS për arsyet e cekura në seksionin pasardhës të Vendimit që flet mbi Projektet kapitale të aprovuara. Rrjedhimisht, kosto e pranueshme e zhvlerësimit të aseteve të reja është 87,484 EUR.

Pas ndryshimeve të cekura më lartë del se vlera e zhvlerësimit të aseteve aktuale dhe atyre të reja që pritet të hyjnë në shërbim të kompanive ajrore rrjedhimisht të pranueshme është 769,084 EUR nga 761,531 EUR sa ka propozuar KANS.

c) Kostoja e kapitalit të aseteve aktuale dhe të reja

Kostoja e kapitalit të propozuar nga KANS për asetet aktuale dhe të reja është në vlerë prej 145,585 EUR. Pas reflektimit të projekteve kapitale të aprovuara nga AAC për t'u financuar nga tarifa në vitin 2026 dhe përmirësimit të gabimeve, kjo vlerë ka ndryshuar në vlerën prej 125,191 EUR. Në këtë kalkulim është marrë parasysh mesatarja e ponderuar e normës së interesit mbi borxhet dhe kthimin nga kapitali e cila për vitin 2026 është vendosur nga AAC-ja të jetë në vlerë prej 4.20% në përputhje me obligacionet 10 vjeçare të publikuara nga BQK. E njëjta vlerë ishte propozuar edhe nga KANS.

Projektet kapitale të aprovuara:

KANS ka dorëzuar një listë të projekteve kapitale 2026 në vlerë prej 1,639,500 EUR. Sidoqoftë kësaj vlere pastaj i janë shtuar edhe 568,594 EUR të projektit AHMS të përfunduar gjatë 2025 duke e rritur vlerën e projekteve kapitale 2026 në 2,208,094 EUR. KANS ka propozuar që këto projekte kapitale të financohen gjatë vitit 2026 nga tarifa terminale e navigacionit 2026 respektivisht kostoja e kapitalit dhe kosto e amortizimit si dhe mjetet e bartura nga viti 2025. Përderisa mjetet në dispozicion nga kostoja e kapitalit dhe amortizimi dihen dhe janë në vlerë prej 894,274 EUR, shumën e mjeteve të bartura nga 2025 nuk dihet prandaj mbetet në përgjegjësi të KANS të veprojnë në realizimin e projekteve kapitale të aprovuara në varësi të mjeteve në dispozicion. Siç specifikohet në dispozitiv të Vendimit, të gjitha ndryshimet në projekte kapitale kërkojnë aprovim paraprak nga AAC.

AAC ka analizuar këtë listë të projekteve kapitale, arsyeshmërinë në dispozicion si dhe nivelin e realizimit të projekteve kapitale të monitoruar ndër vite dhe ka vendosur që t'i pranojë si kosto të arsyeshme projektet kapitale në vlerë prej 1,108,094 EUR në funksion të ofrimit të shërbimit për kompanitë ajrore si në vijim:

Projekti	Vlera e përgjithshme
Blerja e mobileve dhe inventarit	10,000
Tripod me dy anë kalimi të gjerë për akses për persona me aftësi të kufizuara dhe shpërndarje mallrash	6,000
Servera për TI	20,000
Furnizim me sistem për ruajtjen e të dhënave	10,000
Instalim i sistemit për fikjen e zjarrit në Gërmë, Gjakovë dhe objekti gjeneratorëve të KANS	120,000
Sistemi i integruar i Menaxhimit të Sigurisë dhe Cilësisë	50,000
Sistem i ri i PABX	60,000
Printer për printim të kartelave të identifikimit	6,000
Pajisje sinjalizuese me dritë (Light Gun ATC)	7,500
Panela shtesë VCSS SITI JOTRON	250,000
AMHS	568,594
Gjithsej	1,108,094

Në listën e projekteve të propozuara nga KANS ka qenë edhe ndërtimi i katit të dytë të ndërtesës së KANS. Edhe pse AAC mirënjeh nevojën e KANS që të zgjerojë hapësirat e objektit për shkak të rritjes së numrit të punëtorëve, aprovimi i tij ka qenë i pamundur në mungesë të dorëzimit të projektit ideor me paralogari si dhe lejes për ndërtimin e këtij objekti. AAC vazhdimisht ka kërkuar dëshmi për këtë projekt mirëpo KANS ka dështuar që të dokumentojë planifikimin për këtë projekt. Për më tepër dhe pasi që ky projekt poashtu ka qenë i propozuar edhe për vitin 2025 dhe nuk është miratuar nga AAC, më 19 dhjetor AAC duke kërkuar sërish dëshmi për projektin në fjalë ka dërguar në KANS edhe Vendimin e AAC për tarifën 2025 në të cilin specifikohet se mosaprovimi i këtij projekti është vendosur në bazë të mungesës së dëshmive. Sidoqoftë deri në

përfundim të shqyrtimit rregullator më 22 dhjetor 2025 KANS nuk ka dorëzuar asnjë dëshmi përmes të cilës AAC do të kuptonte se si ka ardhur deri tek vlera e propozuar, koston e secilit prej aktiviteteve të projektit dhe afatin kohor të realizimit të tij si kushte të domosdoshme për t'i ngarkuar kompanitë ajrore me këtë kosto.

Në bazë të pikës 2.3.3.2 të Doc. N° 20.60.01 të Eurocontrol "Principles for establishing the cost-base for en route charges and the calculation of the unit rates" në mënyrë që hapësirat dhe shërbimet të mirren parasysh në tarifën e atij viti, ato duhet ose të jenë në funksion ose pritët të hyjnë në funksion deri në fund të atij viti".

Duke marrë parasysh se KANS ka qenë në dijeni për rregullën e përshkruar më lartë dhe pasi që poashtu nuk ka dorëzuar asnjë dëshmi për të mbështetur se kati i dytë funksionalizohet gjatë vitit 2026 (ndërtimi si dhe pajisja e katit ashtu që prej aty të ipen shërbime për kompanitë ajrore) AAC ka vendosur se projekti nuk mund të ketë efekt tarifar gjatë vitit 2026.

Në kuadër të kostos totale të zhvlerësimit dhe të koston së kapitalit për vitin 2026, 132,187 EUR janë përfshirë si kosto të KANS për këto projekte kapitale të reja me pritshmëri që të jenë në funksion për kompanitë ajrore në afate kohore të përcaktuara nga KANS gjatë vitit 2026.

AAC do të inspektojë realizimin e të këtyre projekteve kapitale në vitin e ardhshëm.

Parashikimi i njësive terminale të shërbimit (TSU) 2026:

KANS ka parashikuar rritje të TSU-ve prej 12% për vitin 2026, respektivisht ka parashikuar se do t'i shërbejë 21,641 njësi nga 19,323 njësi sa ka raportuar në Tabela Raportuese se do t'i shërbejë gjatë vitit 2025. Sidoqoftë, në Raportin preliminar të njësive terminale të shërbimit (TSU) për muajin dhjetor 2025 të dorëzuar më 15 dhjetor 2025 KANS ka raportuar se do t'i shërbejë 20,100 njësi gjatë vitit 2025, nga 19,323 njësi sa i kishin deklaruar fillimisht. KANS ka deklaruar se parashikimi prej 12% është bërë në bazë të të dhënave historike.

Parashikimi i saktë i bazës së TSU-ve (viti n) është me rëndësi të veçantë për KANS pasi që parashikimi për vitin (n+1) ndërtohet mbi të, ndërsa konstatimi i gabuar nënkupton axhustime të mëdha në vitin n+2.

Operatori i aeroportit në komunikim drejtuar AAC-së ka parashikuar se viti 2025 do të përmbyllet me mbi 4,627,383 udhëtarë të shërbyer (13,3% rritje në krahasim me 2024), respektivisht 14,648 nisje të fluturimeve (8% rritje në krahasim me 2024). Sipas LKIA, numri i udhëtarëve në vitin 2026 parashihet të ketë një ngritje prej 11.7% në krahasim me vitin 2025 ndërsa numri i fluturimeve të ngritet për 11.3%. Ky parashikim është bazuar në Orarin e fluturimeve për sezonin dimër 2025/2026 dhe aplikimeve të pranuar nga kompanitë ajrore për sezonin e verës të vitit 2026.

AAC-ja ka bërë një kalkulim mbi trafikun dhe numrin e parashikuar të TSU-ve gjatë vitit 2026 duke u bazuar në të dhënat dhe parashikimin e trafikut nga operatori i aeroportit LKIA si të dhënat më mirë të bazuara të numrit të fluturimeve. AAC-ja pret që viti 2025 të përmbyllet me 20,051 njësi terminale të shërbimit ndërsa gjatë vitit 2026 parashikon që do të shërbehen 22,458 njësi terminale që i bie 12% më shumë se në vitin 2025.

Përshtatja për vitin 2024:

Në bazë të Aneksit VI të Rregullores nënmbulimi ose mbimbulimi si rezultat i diferencës midis të hyrave dhe shpenzimeve për vitin 2024 fillon të bartet/përshtatet në vitin 2026.

Sa i përket përshtatjes, gjatë raportimeve KANS ka llogaritur mbimbulimin e kostos për vitin 2024 në vlerë prej 1,546,828 EUR dhe ka propozuar që kjo vlerë t'iu kthehet kompanive ajrore në 4 vitet e ardhshme.

Në bazë të pasqyrave financiare të ASHNA të vitit 2024, përshtatjes përkatëse të zhvlerësimit dhe kostos së kapitalit për projektet kapitale të realizuara gjatë vitit 2024, si dhe përshtatjes nga vitet e kaluara, rezulton se KANS ka mbyllur vitin 2024 me një bilanc prej 1,547,804 EUR. Kjo vlerë do t'i kthehet kompanive ajrore përgjatë 4 viteve (386,951 EUR në secilin vit), dhe do t'i shtohet kësti i mbimbulimit nga vitet 2022 në vlerë prej 236,524 EUR dhe 2023 në vlerë prej 246,484 EUR, që do të rezultojë me 869,959 EUR vlerë që KANS duhet t'ia kthej kompanive ajrore gjatë vitit 2026.

Duhet të kihet parasysh që mbimbulimi, në përputhje me pikën 67 të Manualit të EUROCONTROL për tarifa, konsiderohet borxh ndaj përdoruesve dhe si i tillë duhet të bëhet përpjekje që t'u kthehet përdoruesve (kompanive ajrore) në një kohë të arsyeshme, veçanërisht duke konsideruar kapacitetin aktual të KANS për ta kthyer këtë borxh.

Në bazë të këtyre fakteve dhe konsiderimeve dhe duke pasur parasysh:

- Se propozimi i KANS për tarifë terminale 2026 në vlerë prej 334.29 EUR i llogaritur nën parashikimin e rritjes së njësive të shërbimit më 2026 për 12% apo 21,641 njësive nga 19,323 që kanë parashikuar t'i shërbejnë deri në fund të vitit 2025 përfaqëson një rritje tarife prej 1% krahasuar me tarifën e vitit 2025 në vlerë prej 332.69 EUR;
- Se KANS obligohet sipas Rregullores që të dëshmojë përpjekjet për përmirësimin e efikasitetit të kostove që në kushtet e rritjes së trafikut nënkupton ulje të tarifës për njësi;
- Se AAC-ja ka për qëllim të vendosë një balancë midis operatorëve që japin shërbime nën kushtet e monopolit natyror dhe atyre që i pranojnë këto shërbime;
- Nxitjet financiare të ofruara nga operatori i aeroportit dhe të aprovuara nga AAC-ja për të rritur atraktivitetin e aeroportit;

AAC ka vendosur si vijon:

- Tarifa njësi terminale për vitin 2026 është 313.50 EUR
- Nën parashikimin prej 12% të rritjes së numrit të njësive të shërbyera terminale gjatë vitit 2026 në krahasim me vitin 2025, kostot totale të KANS për të dhënë shërbim cilësor dhe

të sigurt gjatë vitit 2026, të pranueshme për AAC pritet të jenë 8,160,302 EUR. Këto kosto do të mbulohen nga tarifa terminale e navigacionit dhe të hyrat tjera.

Duke marrë parasysh faktet e cekura më lartë, dhe në pajtim me nenin 15.1 (f), 81 të Ligjit nr. 03/L-051 për aviacionin civil, nenin 23 të Ligjit nr. 08/L-305 për Ofruesin e Shërbimeve të Navigacionit Ajror (KANS), si dhe në përputhje me Rregulloren (AAC) nr. 3/2016 mbi përcaktimin e skemës së përbashkët të tarifave për shërbimet e navigacionit ajror, Drejtori i Përgjithshëm i Autoritetit të Aviacionit Civil të Republikës së Kosovës ka vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.


Arianit Islami
UD i Drejtorit të përgjithshëm

Udhëzim mbi mjetin juridik: Në përputhje me nenin 15.7 të Rregullores nr. 3/2016, brenda 7 ditëve nga data e lëshimit të këtij Vendimi, KANS mund të ri-dorëzojë për miratim në AAC propozimin e ri për tarifën njësi terminale për vitin 2026 përmes Tabelave të Raportimit dhe narrativit që përshkruan në hollësi kalkulimin e secilës prej kostove të pranueshme dhe dëshmon nevojën për t'u realizuar këto kosto gjatë vitit 2026. Propozimi i ri duhet të dërgohet në origjinal të shtypur dhe në kopje elektronike në AAC.

Iu dërgohet:

- Ofruesit të Shërbimeve të Navigacionit Ajror (KANS);
- Ministrit të Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës
- Komitetit të kompanive ajrore në ANP "Adem Jashari"
- Departamentit Qendror për Partneritet Publiko-Privat, MFPT
- Aeroportit Ndërkombëtar të Prishtinës "Adem Jashari"
- Arkivit të AAC-së